



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8, paragrafi 1, nën paragrafin 1.6, Nenit 14, paragrafi 2, nën paragrafin 2.6 dhe 2.16, Nenit 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut (Rregulla për Çmimet e OST/OT);
- Aplikacionin e KOSTT-it të dorëzuar në kuadër të Shqyrtimit të Tetë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE8) me dokumentacionin relevant sqarues.
- Vendimin nr. V_633_2014 për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) për OST/OT;
- Metodologjia e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Rrjetit të Sistemit të Transmisionit (TNUOS);
- Metodologjia e Ngarkesave të Operatorit të Sistemit;
- Metodologjia e Ngarkesave të Operatorit të Tregut; dhe
- Kërkesën e datës 26 qershor 2014 të KOSTT SH.A, drejtuar ZRRE-së, për miratimin e ngarkesave të OST/OT;

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, **në seancën e mbajtur më 30 qershor 2014 nxori këtë:**

VENDIM

- I. **APROVOHEN** tarifat dhe ngarkesat, që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) Sh.A për vitin relevant tarifor apo SHTE8 që do të hyjnë në fuqi nga 1 prill 2014.

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar nga KOSTT-i, më datë 26 qershor 2014 kërkesën për shqyrtim të tarifave dhe ngarkesave të OST/OT;
- Për vendosjen e tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në ueb faqen e saj si dhe takimet sqaruese që ka mbajtur me të licencuarit gjatë periudhës shkurt-maj 2014. Këto dokumente janë:
 - Raporti Përfundimtar- Kalkulimi i Kostos me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar me datën 24 qershor 2014;



- Raporti Përfundimtar- Kalkulimi i MAR-it të KOSTT SHA, i publikuar me datën 24 qershor 2014; dhe
- Përgjigjet ndaj Komenteve të KOSTT - Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara, i publikuar me datën 24 qershor 2014.

II. Duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi dhe pas shqyrtimit të të gjitha shënimeve dhe dokumenteve përkatëse, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Struktura e ngarkesave për KOSTT SH.A, që do të zbatohet nga data 1 prill 2014, përkatësisht në vitin relevant tarifor SHTE8 është dhënë në tabelën e mëposhtme:

GRUPI TARIFOR	ELEMENTI TARIFOR	NJËSIA	TARIFA
Prodhimi i Kyçur në Transmision	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.483
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.030
Prodhimi i Kyçur në Distribucion	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.192
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.030
Furnizimi	Tarifa TNUOS 400/220 kV	€/kW	6.509
	Tarifa TNUOS 110 kV	€/kW	12.732
	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.449
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.028

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtar

Krenar Bujupi, anëtar

